



**SHTYLLA I**  
**LEGJISLACIONI SHQIPTAR**

*Zhvillimi i legjislacionit dhe politikave të importit të mbetjeve të parrezikshme në Shqipëri*  
*Nga Av. Florian Xhafa*

**I. ABSTRAKT**

Ky shkrim trajton një temë e cila është debatuar shumë në arenën shqiptare në vitet e fundit: atë të importit të mbetjeve jo të rrezikshme. Kohët e fundit ajo u rikthye në vëmendjen e opinionit publik për shkak të ndryshimeve të mëtejshme ligjore dhe ngriti të njëjtën frikë të vjetër shqiptare në lidhje me çështjen e importit dhe menaxhimit të mbetjeve. Ky shkrim ka për qëllim të shqyrtojë zhvillimet që ka pasur gjatë viteve në këtë fushë, të kryejë analizën e ndryshimeve të fundit ligjore dhe të japë rekomandime për operacionet e ardhshme.

**FJALËT KYÇE:** *Mjedis; Menaxhim i mbetjeve; Trajtim; Riciklim; Rregullore; Politika; Mbetje e rrezikshme; Mbetje e parrezikshme*

**SHKURTIMET**

<b>BE</b>	Bashkimi Europian
<b>Konventa e Bazelit</b>	mbi Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre, 22 Mars 1989
<b>KShM</b>	Katalogu Shqiptar i Mbetjeve
<b>Ligj 10431</b>	Ligj Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
<b>Ligj 10463</b>	Ligj nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar nga ligji 156/2013;
<b>Ligj 156/2013</b>	Ligj nr. 156/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve, të ndryshuar”
<b>Ligj 8934</b>	Ligj nr. 8934 datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”
<b>Ligj 9010</b>	Ligj nr. 9010 datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”
<b>Ligj 92/2016</b>	Ligj nr. 92/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar”
<b>Ligj 9299</b>	Ligj nr. 9299 datë 28.10.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë me Vendimin III/1, amendament i Konventës së Bazelit “Për lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”
<b>Ligj 9537</b>	Ligj Nr. 9537 datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
<b>NOQ</b>	Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm
<b>NJQV</b>	Njësitë e Qeverisjes Vendore
<b>PIA</b>	Vlerësim i Impaktit të Politikave



**Regjistri NShT**

**RIA**

**VKM**

**VKM 418**

**VKM 608**

**VKM 806**

**VKM 825**

**VKM 835**

**VKM 99**

Regjistri i Ndotjes, Shkarkimit dhe Transferimit

Vlerësim i Impaktit Rregullator

Vendim i Këshillit të Ministrave

VKM Nr. 418 i 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”

VKM Nr. 608, datë 17.09.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio, si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”

VKM Nr. 806, datë 4.12.2003 “Për miratimin e rregullave e të procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim e riciklim”

VKM Nr. 825, datë 13.10.2010 “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”

VKM Nr. 835, datë 28.12.2005 “Për miratimin e listës së mbetjeve, të rrezikshme dhe mbeturinave të tjera, që ndalohen të importohen me qëllim ruajtjeje, depozitimi dhe asgjësimi”

VKM Nr. 99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të mbetjeve”

## II. HYRJE

Gjatë dekadave të fundit, Shqipëria ka pësuar një zhvillim social dhe ekonomik intensiv dhe mjaft kaotik, për sa i përket mjedisit. Arsyeja kryesore është se nuk ka marrë parasysh siç duhet parimin e “zhvillimit të qëndrueshëm”, i cili kërkon ekuilibrim mes zhvillimit ekonomik dhe social me mjedisin përreth (ajrin, ujin, tokën, biodiversitetin). Kjo situatë është krijuar nga elementët kryesore të mëposhtëm:

- i. Investime të pakontrolluara të biznesit, përfshirë edhe në veprimtarinë bujqësore;
- ii. shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve natyrore;
- iii. mungesa e koordinimit mes pushtetit qendror dhe vendor në formulimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit.

Mungesa e vëmendjes për çështjet e mjedisit, gjatë miratimit dhe zbatimit të politikave të zhvillimit, ka çuar në tregues alarmantë të ndotjes<sup>1</sup>. Për më tepër, një tjetër aspekt i rëndësishëm që ndikon mjedisin në mënyrë të konsiderueshme është apatia sociale dhe mospërfillja ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe burimeve natyrore. Shkaqet kryesore të ndotjes janë identifikuar nga një numër i konsiderueshëm projektsh, të financuara nga donatorët ndërkombëtarë (BE, BB, UNDP, etj) dhe janë si më poshtë:

- i. mungesa e grumbullimit dhe riciklimit të mbetjeve në zonat urbane dhe rurale;
- ii. përdorimi i rrugëve, lumenjve, liqeneve si vend grumbullimi të mbetjeve urbane;
- iii. përdorimi i pa kontrolluar i Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm;;
- iv. mungesa e koordinimit ndër-institucional, si pasojë e drejtpërdrejtë e ndarjes së papërshtatshme të funksioneve zyrtare të kontrollit;

<sup>1</sup> <http://www.akm.gov.al/cil%C3%ABsia-e-mjedisit.html#monitorime>

v. mungesa e monitorimit të prodhimit të mbetjeve dhe shkarkimit të tyre në mjedis si pasojë e mosfunksionimit të Regjistrisë NShT<sup>2</sup>.

Gjatë viteve të fundit, politikat mjedisore dhe instrumentet ligjore për zbatimin e tyre kanë fituar vëmendje të veçantë të qeverisë qendrore si dhe të publikut të gjerë, por burimet administrative dhe teknike për zbatimin e tyre mbeten ende të pamjaftueshme.

### III. ANALIZA E KRONOLOGJISË SË KUADRIT RREGULLATOR TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Politikat dhe kuadri ligjor shqiptar që rregullon mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve, ka pësuar disa ndryshime të rëndësishme në dekadat e fundit. Këto ndryshime, në aspektin e opsioneve të politikave, instrumenteve ligjore, ose zgjidhjeve administrative, janë nxitur nga tre faktorë kryesorë:

- i. vullneti politik për të tërhequr simpatinë ose vëmendjen e opinionit publik dhe për të ngritur shqetësime në lidhje me këtë çështje;
- ii. presioni ndërkombëtar, për shkak të ndikimit ndërkufitar të ndotjes së mjedisit;
- iii. proceset e integritimit të Shqipërisë në organizata të ndryshme ndërkombëtare (OKB, BE, OBT, etj.)
- iv. reagimi emergjent mbi mbetjet e rrezikshme dhe hot-spotet<sup>3</sup>, për shkak të ndotjes industriale (trashëguar kryesisht nga industrinë e kaluara kimike).

Këta faktorë, pavarësisht gamës së tyre të gjerë në lidhje me mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve, nuk kanë ofruar vizion të mjaftueshëm politik dhe përpjekje të strukturuar për të zhvilluar politika të qëndrueshme dhe për të krijuar instrumentet e nevojshme të harmonizuara për të zgjidhur problemet e trajtimit dhe grumbullimit të mbetjeve, në nivel qendror dhe nivel lokal.

#### 1. Periudha 2002-2006

Përpjekja e parë e madhe rregullatore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, dhe në veçanti, atë të menaxhimit të mbetjeve është bërë gjatë periudhës 2002 - 2006. Gjatë kësaj periudhe u përcaktuan kuadri i përgjithshëm si dhe disa procedura për menaxhimin e mbetjeve, për importin dhe eksportin. Ligji 8934 (*tashmë i shfuqizuar*), përcaktoi kërkesat themelore për rregullimin e marrëdhënies midis veprimtarisë njerëzore dhe mjedisit, duke siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe përbërësve të tij dhe zbatimin e objektivit kushtetues për të pasur një mjedis ekologjikisht të shëndoshë për brezat e sotshëm dhe të ardhshëm<sup>4</sup>. Përsa i përket menaxhimit të mbetjeve, Ligji 8934, përcakton në nenin 22 se importi i mbetjeve jo të rrezikshme, lejohej në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim përdorimin, përpunimin dhe riciklimin, vetëm pas një miratimi rast pas rasti të lëshuar përmes një VKM-je të veçantë. Mbetjet e përmendura mund të ishin vetëm ato të llojit të përfshirë në listën e miratuar të mbetjeve, importi i të cilave lejohej për qëllimin e përcaktuar. Bazuar në nenin 22 të Ligjit 8934 u miratuan aktet e nevojshme nënligjore dhe konkretisht: (i) VKM 806 (*tashmë e shfuqizuar*), e cila rregullonte importin e mbetjeve jo të rrezikshme për qëllim të përdorimit, procesimit dhe riciklimit; (ii) VKM 99 (*tashmë e shfuqizuar*), e

<sup>2</sup> Siç kërkohet nga neni 32 i Ligjit 10431/2011 dhe Protokollin UNECE Protocol mbi Regjistrinë NShT.

<sup>3</sup> Hot-Spot në kontekstin e ndotjes konsiderohen zonat ndotja e të cilave ka kaluar normat e lejuara dhe përbëjnë rrezik.

<sup>4</sup> Neni 59 (1) (d) i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

cila ndante mbetjet në “të rrezikshme” dhe “jo të rrezikshme”, në përputhje me dispozitat e Direktivës EC 2000/532 / EC (*tashmë e shfuqizuar*); (iii) VKM 835 (*tashmë e shfuqizuar*) nxjerrë në përputhje me KShM-në.

Në vitin 2003, u miratua Ligji 9010 (*tashmë i shfuqizuar*), i cili solli kuadrin e plotë rregullator për menaxhimin e mbetjeve të ngurta. Nëpërmjet neneve 8 dhe 26, Ligji 9010, ndaloi importin e çdo lloj mbetjeje (të rrezikshme dhe jo të rrezikshme) për qëllime të tjera përveç përdorimit dhe riciklimit, dhe posaçërisht për qëllime të ruajtjes, depozitimit dhe asgjësimit, duke qenë në harmoni me dispozitat e Ligjit 8934.

Në vitin 2004, Shqipëria ratifikoi Konventën e Bazelit nëpërmjet Ligjit 9299, duke u vendosur në linjë me standardet ndërkombëtare të ndarjes së mbetjeve sipas listës së Gjellbër dhe listës së Bazelit. Pas ratifikimit të Konventës së Bazelit, u miratua në vitin 2006 Ligji 9537 (*tashmë i shfuqizuar*) i cili përcaktoi normat që rregullonin menaxhimin e sigurt të mbetjeve të rrezikshme si dhe grumbullimin, transportimin, përpunimin, trajtimin dhe eksportimin e tyre. Neni 20 i Ligjit 9537 ndaloi importin e mbetjeve të rrezikshme për çdo qëllim, në territorin e Shqipërisë.

Si rezultat i kuadrit ligjor të lartpërmendur të miratuar gjatë periudhës 2002-2006, situata në lidhje me importin e mbetjeve ishte si vijon:

- i. mbetjet ndaheshin në të rrezikshme dhe të parrezikshme;
- ii. importi i mbetjeve të rrezikshme në Shqipëri u ndalua;
- iii. importi i mbetjeve të parrezikshme me qëllim përdorimin, përpunimin dhe riciklimin lejohej;
- iv. importi i mbetjeve të parrezikshme me qëllim ruajtjen, depozitimin dhe asgjësimin ndalohej.

Vlen të theksohet se legjislacioni dhe politikat e lartpërmendura në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, përfshirë importin dhe eksportin e tyre, përcaktuan kornizën kryesore, e cila u zbatua vetëm pjesërisht për shkak të mungesës së paketës së plotë të akteve nënligjore, të procedurave administrative dhe të infrastrukturës që lidhej, për shembull, me ndarjen dhe grumbullimin e mbeturinave në burim, landfillet, riciklimin, etj, si dhe për shkak të mungesës së kapaciteteve të financimit dhe të ndërgjegjësimit të publikut. Kjo situatë u përkeqësuar edhe më tej për shkak të kompleksitetit në shpërndarjen e funksioneve mes institucioneve të ndryshme të përfshira dhe sjelljes jo korrekte të operatorëve ekonomikë dhe familjarë, në drejtim të vetë mjedisit. Në anën tjetër, importi i mbetjeve të parrezikshme për qëllimet e lejuara, u krye gjatë kësaj periudhe nga operatorët privatë, bazuar në interpretimin e VKM-së 835, e cila rendiste mbeturinat e rrezikshme të cilat ishin të ndaluara dhe nuk mund të importoheshin, duke lënë të hapur të drejtën për të importuar pothuajse të gjitha mbeturinat e tjera të listuara si të parrezikshme.

Kjo kornizë rregulluese dhe procedurat përkatëse, nuk ishin në përputhje as me dispozitat ligjore të BE-së të përcaktuara me anë të vendimit të Komisionit të BE-së 94/721 / KE (*tashmë i shfuqizuar*), i cili themeloi Listën e Gjellbër të Mbetjeve, ku përfshiheshin rreth 168 produkte, dhe as me Listën e Gjellbër<sup>5</sup> të Konventës së Bazelit, ku përfshiheshin rreth 179 produkte. Si rrjedhojë ekzistonte një boshllëk ligjor

<sup>5</sup> Aneksi IX i Konventës së Bazelit.

në Shqipëri lidhur me këtë çështje. Përveç kësaj, kuadri rregullator, në lidhje me menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të zeza, ishte mjaft i kufizuar dhe nuk ofronte procedura të mjaftueshme për zbatimin e detyrimeve të përgjithshme të përcaktuara prej tij. Situata e menaxhimit të mbetjeve u përkeqësua edhe për shkak të burimeve dhe infrastrukturës së kufizuar, duke bërë që “vend-depozitimet” të ishin pothuajse e vetmja alternativë për menaxhimin e mbetjeve.

## 2. Periudha 2008

Një tjetër hap i rëndësishëm në drejtim të menaxhimit të përshtatshëm të mbetjeve, veçanërisht në lidhje me importin dhe eksportin e mbeturinave, është bërë në vitin 2008, me miratimin e VKM-së 825. Kjo VKM miratoi Listën e Gjellbër të Mbetjeve që përfshinte produktet e mbetjeve të parrezikshme të BE-së që mund të importoheshin ose të eksportoheshin për qëllimet e përmendura më lart. Lista e mbetjeve të cilat sipas përcaktimeve të VKM 825 lejoheshin të importoheshin, ishte më kufizuese se Lista e Gjellbër e BE-së duke qenë se lejonte importimin në territorin shqiptar, të vetëm 55 produkteve nga 168 produktet e përfshira në listën e BE-së.

Për sa i përket aspektit procedural, një tjetër përmirësim që VKM 825 i solli situatës së kohës, ishin ndryshimi i Kodit të Nomenklaturave të mbetjeve që mund të importoheshin (G-gjellbër) dhe mbetjet që nuk mund të importoheshin (B-Bazel). Kjo praktikë u mundësoi autoriteteve doganore të kryenin kontrollet e duhura në kufij. Për më tepër, kjo procedurë u plotësua, duke shtuar kërkesën e dokumenteve të “njoftimit” dhe “lëvizjes” për transferimin/lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve siç përcaktohej nga Konventa e Bazelit, të cilat u kërkoheshin operatorëve që merrnin pjesë në procesin e importit, eksportit dhe transportit të mbeturinave. Pavarësisht dispozitave të përgjithshme të VKM 825, autorizimi i importit të mbetjeve lëshohej rast pas rasti për çdo operator dhe për çdo sasi mbetjesh dhe vetëm pas përmbushjes së kërkesave specifike të VKM nr. 806.

## 3. Periudha 2011-2014

Reforma e tretë rregullatore për mjedisin dhe menaxhimin e mbetjeve u realizua gjatë periudhës 2011-2014, dhe është ende kuadri rregullues i kësaj fushe. . Një numër i madh normash u miratuan gjatë kësaj periudhe, si një kërkesë e drejtpërdrejtë e nenit 70 të Marrëveshjes së MSA-së, lidhur me përafrimin e legjislacionit mjedisor me "acquis". U miratua ligji organik për mbrojtjen e mjedisit, Ligji 10431, së bashku me ligjin organik për menaxhimin e mbetjeve, Ligji 10463, dhe aktet e tyre nënligjore<sup>6</sup>. Kjo

<sup>6</sup> VKM nr. 175, datë 19.01.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”; VKM nr. 177 datë 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”; VKM nr. 178, datë 06.03.2012 “Për incinerimin e mbetjeve”; VKM nr. 452, datë 11.07.2012 “Për lëndfilllet e mbetjeve”; VKM nr. 705, datë 10.10.2012 “Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës”; VKM nr. 765, datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”; VKM nr. 866, datë 4.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”; VKM nr. 957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”; VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullore për administrimin e mbetjeve spitalore”; VKM nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”; VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”; VKM nr. 418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”; VKM nr. 608, datë 17.09.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret

paketë ligjore pasuroi kuadrin ligjor shqiptar me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit të tilla si (i) detyrimin e ndotësve që të paguajnë për mbetjet që ata prodhojnë; (ii) statusin e fund jetës së mbetjeve<sup>7</sup>; (iii) procedura dhe kritere të ndryshme që rregullonin menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave specifike; (iv), si dhe detyrimet e autoriteteve publike në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

Lidhur me importin dhe eksportin e mbetjeve, gjendja e rregulluar me VKM-në 825, u zhvillua më tej nga ligji 10463 në aspektin e kufizimeve të mëtejshme dhe kontrollit procedural. Megjithatë një nga premtimet kryesore të Partisë Socialiste gjatë periudhës së zgjedhjeve të vitit 2013, ishte bllokimi total i importit të mbetjeve. Ky premtim u bazua në dy argumente kryesore: Shqipëria nuk është në përputhje me standardet e kërkuara, dhe nuk ka kapacitetet infrastrukturore dhe administrativ për të kontrolluar dhe menaxhuar importin e mbetjeve; Shqipëria duhet të garantojë standardet për trajtimin e mbetjeve të veta, dhe duhet të zhvillojë sistemet e nevojshme për monitorimin e importit dhe eksportit të mbetjeve.

Gjithashtu duke u mbështetur në këto argumente, organizatat mjedisore dhe një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, mblodhën mijëra nënshkrime, me qëllim të mbajtjes së një referendumi për shfuqizimin e neneve përkatëse të ligjit 10463, i cili lejonte importin e 55 produkteve të mbetjeve (nga 168 produkte të parashikuara nga lista e BE-së, siç ishte përcaktuar me VKM-në 825). Referendumi nuk u mbajt asnjëherë duke qenë se Partia Socialiste fitoi zgjedhjet dhe premtoi shfuqizimin e nenit përkatës nëpërmjet një nisme ligjore (ndryshimin e Ligjit 10463). Në fakt, Qeveria e re hartoi dhe Parlamenti miratoi ligjin 156/2013, i cili ndaloi importin e mbetjeve të rrezikshme dhe të parrezikshme në Republikën e Shqipërisë.

Ky ligj përcaktoi gjithashtu se shfuqizohej çdo dispozitë e legjislacionit shqiptar që binte në kundërshtim me ndalimin e importit, që do të thotë se edhe VKM 825 shfuqizohej. Nuk ka të dhëna nëse ndryshime të tilla kaq drastike, të legjislacion dhe politikave shqiptare në lidhje me importin e mbetjeve, u realizuan pas kryerjes së një PIA apo RIA paraprake mbi këtë fushë, të cilat do të kishin dhënë argumente të mjaftueshme për një vendim të tillë. Pa i hyrë argumenteve pro dhe kundër vendimit politik, ky i fundit solli disa kufizime nga pikëpamja e analizës ligjore dhe në veçanti: (i) e ktheu procesin e përafrimit të legjislacionit mjedisor me 'acquis', të parashikuar në nenin 70 të VKM-së 825, një hap prapa, siç parashikohet në; (ii) vendosi në mënyrë të njëanshme masa më kufizuese në tregtinë midis palëve, në krahasim me ato të përcaktuara nga Marrëveshja e Përkohshme e MSA-së, prandaj shkeli dispozitat e saj<sup>8</sup>.

#### 4. Periudha 2013-2016

Nuk ka pasur ndryshime të mëdha në legjislacion apo në politika, në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, gjatë periudhës 2013-2016. U realizuan pak investime për landfillet ndërsa sistemi i mbledhjes së

---

dhe afatet për pakësimin e tyre"; VKM nr. 641 datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte".

<sup>7</sup> **Kuptimi i statusit të fund jetës së mbetjeve:** një produkt nuk do të konsiderohet si mbetje, kur përputhet me kushtete e përcaktuara për lëndët e para ose kur tregu kërkon të konsiderohet si lëndë e parë.

<sup>8</sup> Megjithatë nuk është gjetur asnjë gjurmë e ndonjë njoftimi apo denoncimi të këtij veprimi nga palët.

mbetjeve të ndara në burim nuk ka filluar të zbatohet nga bashkitë deri së fundmi. Edhe tani, ky proces po kryhet vetëm në disa qytete, si Tirana apo Korça.

Gjatë vitit 2016, pati një propozim të ri qeveritar i cili zhvendoste në mënyrë drastike legjislacionin dhe politikën në lidhje me importin e mbetjeve, nga ndalimi absolut në drejtim të kundërt. U miratua Ligji 92/2016, i cili lejon importin e mbetjeve të përfshira në Listën e Gjellbër. Ky veprim kërkonte së pari miratimin e listës së Gjellbër, që përmban listën e mbetjeve që lejohet të importohen, e cila ekzistonte më parë, por u shfuqizua në vitin 2013 së bashku me VKM-në 825. Pavarësisht mungesës së Listës së Gjellbër, Ligji 92/2016 ndryshoi nenin 48/1, paragrafi 1 të Ligjit 10463, duke përcaktuar të drejtën për të importuar mbetjet të ngurta të parrezikshme, për qëllime të përdorimit si lëndë e parë, në industrinë e riciklimit dhe industri të tjera, duke mos përfshirë aktivitetet e djegies së mbetjeve. Në të njëjtën kohë, qeveria lëshoi një mori lejesh për veprimtarinë e djegies së mbetjeve.

Miratimi i këtij akti u shoqëruar me reagimin e konsiderueshëm të publikut, bazuar në të cilën Presidenti, nuk miratoi hyrjen e tij në fuqi. Argumenti që qeveria i dha opinionit publik, për një ndryshim të tillë, ishte se këto ndryshime të reja ligjore nuk lejonin hyrjen e mbeturinave, por të produkteve primare të nevojshme për industrinë e riciklimit. Së dyti u shpjegua se vendi tashmë ishte gati për të administruar dhe kontrolluar procesin e importit nëpërmjet procedurave administrative dhe strukturave të posaçme.

#### **IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

Reforma legjislative, rregullatore dhe e politikave në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri, realizuar përgjatë dekadës së fundit, është përmirësuar ndjeshëm, megjithatë kjo nuk është shoqëruar me financim të nevojshëm në infrastrukturë, burime njerëzore, dhe kapacitete administrative. Një problem madhor ka qënë mungesa e transparencës dhe përdorimi i shpeshtë si një mjet politik nga ana e aktorëve politikë shqiptarë. Të gjithë këta elemente kanë përcjellë tek publiku perceptimin e përgjithshëm se këto reforma janë ndërmarrë vetëm për qëllime politike, duke i shërbyer sektorëve të caktuar ekonomikë. Ky perceptim është ushqyer edhe nga argumentet e paqarta të ofruara nga aktorët politikë, kur shprehen në favor apo në kundërshtim me ndërrimet drastike të legjislacionit në lidhje me këtë çështje.

Në çdo rast, sipas një këndvështrimi strikt ligjor të ndryshimit të ndërmarrë në vitin 2013 i cili përcaktoi ndalimin e plotë të importit të mbetjeve ishte një shkelje e qartë e të drejtës ndërkombëtare, e cila mund të rregullohej vetëm me miratimin e ligjit Ligji 96/2016, i cili është ende pezull. Kjo nuk përjashton përgjegjësinë e Shqipërisë për të vlerësuar paraprakisht të drejtat dhe detyrimet e saj, si dhe kapacitetet e brendshme të nevojshme për zbatimin e duhur të ligjit ndërkombëtar. Si rrjedhojë, çdo proces i ratifikimit të marrëveshjeve apo konventave ndërkombëtare duhet të paraprihet në çdo rast nga një PIA dhe një RIA, si dhe nga një studim fizibiliteti në lidhje me kapacitetet zbatuese të vendit. Këto procese do të pengonin keqpërdorimin për arsye politike apo populiste, të politikave, të normave rregullatore, si dhe të ratifikimit të instrumenteve ligjore ndërkombëtare. Në terma konkretë, për të siguruar menaxhimin e duhur të mbetjeve, si dhe një import të kontrolluar të mbetjeve, autoritetet publike shqiptare duhet të garantojnë të paktën kushtet e mëposhtme:

- i. krijimi i një procedure që funksionon mirë, për ndarjen e mbetjeve në burim;

- ii. krijimi i landfilleve për mbetjet që nuk mund të riciklohen dhe të ripërdoren, me standardet e duhura për mbrojtjen e mjedisit;
- iii. standardizimi i operacioneve të djegies, ndalimi i çdo veprimtarie të djegies së mbetjeve të dëmshme / rrezikshme, kryerja e operacioneve të djegies në përputhje me standardet më të larta teknologjike, dhe vendosja e kushtit për ta kthyer procesin e djegies në një veprimtari të dobishme për komunitetin ku kryhet, duke siguruar energji (energji elektrike; ngrohje dhe ftohje të energjisë etj);
- iv. zbatimi i kontroleve zyrtare të mbetjeve të importuara që garantojnë se asnjë produkt tjetër përveç atyre të parashikuara në Listën e Gjelbër, nuk mund të hyjë në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe që garantojnë se hyrja pranohet vetëm për përdorimet e lejuara.
- v. Zbatimi i parimeve të mbrojtjes së mjedisit, të tilla si “ndotësi paguan” dhe “statusi i fund jetës së mbetjeve” të udhëheqin politikat dhe procedurat e menaxhimit të mbetjeve.
- vi. Zbatimi i proceseve transparente për çdo politikë të miratuar të qeverisë në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, duke siguruar mundësi për komunitetet e prekura për të shprehur mendimet e tyre dhe për të marrë pjesë në procedurat vendimmarrëse. Kjo është akoma më e rëndësishmja kur konsiderohet se menaxhimi i mbetjeve është një çështje shumë e ndjeshme, jo vetëm për komunitetet lokale, por edhe për komunitetet ndërkufitare, për shkak të potencialit të shtrirjes së dëmeve që kanë mbetjet.

Së fundmi, është e nevojshme të theksohet se një tjetër element i rëndësishëm i lidhur ngushtë me dhe që ndikon në importin e mbetjeve, është menaxhimi i mbetjeve në nivel lokal. Ndërsa debati publik dhe politik për importin e mbetjeve ende vazhdon në mënyrë energjike, debati mbi detyrimin e pushtetit vendor, njësitë të qeverisjes vendore, për të mbledhur, hequr dhe trajtuar mbetjet e ndodhura në territorin e tyre është errësuar krejtësisht. Ky aspekt i rëndësishëm i çështjes nuk ka marrë ndonjë vëmendje të madhe.

Vlen të sqarohet se, Njësitë e Qeverisjes Vendore janë të detyruara të menaxhojnë mbetjet territoriale për shkak të pikës 4 të VKM-së 608 që përcakton se “*afati kohor për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve bio nga NJQV-të është: (a) brenda vitit 2017 për komunat (në qendër të rajonit); (b) brenda vitit 2018 për komunat tjera*”. Për më tepër, sipas Kapitullit IV të VKM-së 418 “*Bashkitë e kategorisë 1, duhet të caktojnë deri në 31 dhjetor 2016, masat e duhura për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve, të paktën për: a) letrën; b) metalet; c) plastikën; dhe d) qelqin*” dhe “*Komunat e tjera, duhet të caktojnë këto masa, brenda 31 dhjetorit 2018*”. Për më tepër Ligji 10463 përcaktonte se çdo qark ka detyrimin të hartojë dhe miratojë planin rajonal për menaxhimin e integruar të mbetjeve për territorin në juridiksionin e tij, në përputhje me Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

Si rezultat, çështja e importit të mbetjeve nuk duhet të konsiderohet si një problem i izoluar ose si problemi kryesor i mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve. Importi i mbetjeve është vetëm një aspekt i problemit më të madh të Shqipërisë në lidhje me procedurat dhe kapacitetet për menaxhimin e mbetjeve. Për këtë arsye ligjet dhe politikat që trajtojnë çështjen e mbetjeve, duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të rregullojnë të gjitha aspektet e fushës, duke filluar nga mbledhja e brendshme, trajtimi, shkarkimi etj deri tek import-eksporti, transporti, tranziti etj. Çështja e mbetjeve mund të trajtohet vetëm brenda një kuadri ligjor dhe politik koherent.